



Akt - Themelimi i shoqërisë tregtare

“Llazo”

Sot më datë **15. 01. 2002** unë i nënshkruari Andon Llazo , me dëshirën dhe vullnetin tim të plotë, në mbështetje të Ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nr. 7667 datë 28.01.1993 “Për regjistrimin në regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” vendosa që të formuloj këtë akt për themelimin e një shoqërie tregtare private me përgjegjësi të kufuzar sh.p.k. si më poshtë vijon:

Neni 1.

Të formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “LLazo ” sh.p.k.

Neni 2.

Shoqëria do ta ketë qendrën e vet në Gorre, Lushnje

Neni 3.

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje mbi dhjetë vjet punë të njëpasnjëshme. Ky afat mund të zgjatet por edhe mund të shkurtohet për rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që do të pasqyrohen në statut.

Neni 4.

Themelues i shoqërisë është zoti Andon Llazo i cili është edhe ortak i vetëm i saj si dhe administrator i shoqërisë.

Neni 5.


Shoqëria tregtare “Llazo ” sh.p.k. ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- tregti me shumice e pakice dhe import-export te artikujve dhe mallrave te ndryshem industriale ,lavazh,materiale ndërtimi, inerte & bar.

Neni 6.

Për fillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie themeluesi i saj ka vënë një një kapital fillestare prej 100.000 lekësh, shumë e cila është pronë vetjake e themeluesit si ortak i vetëm.





Neni 7.

Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakut të vetëm të shoqërisë, zotit Andon Llazo. Ky fitim do të disponohet lirisht prej tij pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve.

Neni 8.

Organ vendimor në shoqëri është ortaku i vetëm zoti Andon Llazo i cili e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror si dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

Neni 9.

Do të konsiderohen veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet ose punonjësit e saj, konform disponimeve në statutin e saj dhe në mbështeje të legjislacionit në fuqi.

Neni 10.

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11.

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

Neni 12.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në rast se kjo nuk arrihet, ato do të zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 13.

Ky akt themelimi përpilohet në 5 kopje të barabarta në gjuhën shqipe, njëra prej të cilave do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregëtare "LLazo" sh.p.k. Lushnje

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

.....

Andon LLazo



Statut i shoqerise private me përgjegjësi të kufizuar

“Llazo”

Sot më datë 15. 01. 2012 zoti **Andon Llazo** si ortak i vetëm, në mbështetje të Aktit të Themelimit, harton këtë statut bazë për karakterin dhe veprimtarinë e shoqërise tregtare me përgjegjësi të kufizuar, i cili konsiston si më poshtë:

Forma, Emri.

Neni 1.

Shoqëria do të jetë një shoqëri tregtare private me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “Llazo” sh.p.k. dhe e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar për shoqëritë tregtare, statutin e saj dhe Aktin e Themelimit.

Kohëzgjatja.

Neni 2.

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje mbi dhjetë vjet punë të njëpasnjëshme, duke filluar ky afat nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 3.

Periudha e veprimtarisë ekonomike mund të zgjatet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë ose mund të shkurtohet në rastin kur do të vërtetohet shpërbërja e saj, para afatit të përcaktuar në Nenin 2 të këtij statuti.

Qendra e shoqërisë.

Neni 4.

Shoqëria qendrën e saj ne fshatin Gorre Lushnje .

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të ndryshojë vendin e qendrës së shoqërisë. Po me vendim të tij, shoqëria mund të çelë vendqendrime të dyta operative.

Neni 5.

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mund të çelë degë të saj edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Këto degë do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe të vendeve ku do të ngrihen.



Objekti i veprimtarisë së shoqërise.

Neni 6.

Shoqëria tregtare "Llazo" sh.p.k. ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- tregëti me shumice e pakice dhe import-export te artikujve dhe mallrave te ndryshem ,industriale , materiale ndërtimi, inerte , lavazh e bar.

Neni 7.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të zgjerojë aktivitetin e tij në të ardhmen duke lidhur kontrata apo akt-marrëveshje me persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj. Mbi këtë bazë do të zgjerohet edhe fusha e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 8.

Do të konsiderohen veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet ose punonjësit e saj konform disponimeve të këtij statuti dhe kurdoherë në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Kapitali themelor i shoqërise.

Neni 9.


Për fillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie ortaku i vetëm saj vë një kapital fillestar që kap shumën prej 100.000 lekësh, shumë e cila është kontribut dhe pronë vetjake e ortakut.

Neni 10.

Për administrimin dhe qarkullimin e kapitalit të shoqërisë hapet edhe një llogari rjedhëse dhe likuiduese pranë bankës. Kapitali themelor i shoqërisë është lirisht i transferueshëm në rrugë trashgimie ose në formë shitje. Tjetërsimi pasurisë në këto raste do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Neni 11.

Gjithë fitimi i kësaj shoqërie i përket ortakut të vetëm të saj, zotit Andon Llazo , i cili është edhe pronar i saj. Ky fitim do të disponohet lirisht pasi të jenë shlyer më parë detyrimet fiskale dhe ato ndaj të tretëve.



Organet drejtuese të shoqërisë.

Neni 12.

Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është ortaku i vetëm i saj, zoti Andon Llazo , i cili e përfaqëson atë juridikisht në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror si dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë. Ortaku i vetëm i shoqërisë është njëkohësisht dhe administrator i saj. Me autorizimin me shkrim të nënshkruar nga ortaku i vetëm, shoqërinë mund ta përfaqësojë çdo person tjetër.

Neni 13.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime kryesore:

- organizon punën dhe përfaqëson shoqërinë
- lidh dhe nënshkruan kontrata si dhe akte të tjera
- bën caktimin e punëtorëve në vendet e punës
- jep masat disiplinore
- bën zgjidhjen e konflikteve në mes punëtorëve
- kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore, dispozitave të këtij statuti dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me veprimtarinë private.

Administrimi, viti financiar, bilanci.

Neni 14.

Mjetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato të shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar regjistrohen në librin afarist të shoqërisë menjëherë. Shoqëria është pronare, përdoruese, disponuese e pasurive në emër të vet në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimitarisë së saj.

Neni 15.

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e viti financiar dhe çdo raport tjetër i veçantë në këtë drejtim, pas shqyrtimit i paraqiten përmiratim pronarit të shoqërisë brenda tre muajve dhe në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data e mbyllijes së vitit.

Neni 16.

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen me bilancet e saj, me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatuara në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me të huaj dhe e



Kundëta bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka në momentin e këmbimit të saj.

Punësimi në shoqëri.

Neni 17.

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen në përmjet kontratës së punës, e cila mund të jetë kolektive dhe individuale. Cështjet të cilat nuk gjijnë rregullim në kontratat e punës zgjidhen sipas legjisacionit shqiptar: Kodi i Punës dhe çdo akt tjetër ligor e nënligjor që ka të bëjë me këtë çështje.

Neni 18.

I punësuari nuk merr pjesë në ndarien e fitimit të cilin e realizon shoqëria gjatë veprimtarisë së saj apo edhe në humbjet e saj, nëse në kontratën e punës nuk është përcaktuar ndryshe.

Ai përgjigjet materialisht për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj.

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë.

Neni 19.

Shoqëria mund të shpërbëhet në rastet:

- me vendim të ortakut të vetëm të saj kur për dy vjet radhazi shoqëria nuk rezulton rentabel
- Me plotësimin e afatit të kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqërisë
- Në rast falimentimi ekonomik
- Në ato raste kur shprehimisht do të citohet një gjë e tillë nga legjislationi në fuqi.

Neni 20.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e prishjes ose të shpërbërjes. Pa shlyerjes së detyrimeve tatuese fiskale dhe atyre ndaj të tretëve përcaktohen pasuritë e ngelura, të cilat i kthehen tërësisht ortakut të vetëm të shoqërisë që është dhe pronar i saj.

Dispozita të përgjithshme.

Neni 21.

Mosmarrëveshjet juridiko-civile të lindura midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, kur nuk mund të zgjidhen në mirëkuptim me njëri tjetrin, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë ose çdo Gjykatë tjetër kompetente sipas legjisacionit shqiptar.